

20131473515

**LIGJ  
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBIKËQYRJË  
INSPEKTUESE**

Neni 1

Në Ligjin për mbikëqyrje inspektuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 50/10, 162/10 dhe 157/11), neni 1 ndryshohet si vijon:

"(1) Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e lëshimit dhe marrjes së lejes për inspektor, të drejtat dhe detyrat e inspektorëve, bazat për organizimin dhe punën e shërbimeve inspektuese, të drejtat dhe obligimet themelore të subjekteve të mbikëqyrjes inspektuese, statusi dhe puna e Këshillit Inspektues, mënyra dhe procedura e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, si dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese.

(2) Dispozitat e këtij ligji zbatohen në të gjitha procedurat e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nga shërbimet inspektuese të organizuara si organe në përbërje të ministrive (në tekstin e mëtejshëm: inspektorate), apo si njësi organizative në kornizat e organeve të administratës shtetërore dhe njërive të vetëqeverisjes lokale dhe qytetit të Shkupit, përveç në procedurat e posaçme të kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese në sferën e punës tatimore, doganore dhe financiare të përcaktuara me ligj."

Neni 2

Në nenin 2 pika 1 pas fjalëve: "kompetencat inspektuese" shtohen fjalët: "të përcaktuara me ligj".

Pika 3 ndryshohet si vijon:

"Procedura inspektuese është procedurë për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese, parimet themelore të së cilës rregullohen me këtë ligj."

Pika 6 ndryshohet si vijon:

"Subjekti i mbikëqyrjes inspektuese është person juridik apo fizik apo subjekt tjetër i përcaktuar me ligje në të cilin parashihet kryerja e mbikëqyrjes inspektuese."

Neni 3

Në nenin 8 paragrafi 2 pika zëvendësohet me prerje dhe shtohen fjalët: "si dhe me urdhër të dhënë nga kryetari i Këshillit Inspektues."

Neni 4

Pas nenit 12 shtohet nen i ri 12-a, si vijon:

"Neni 12-a  
Përdorimi i gjuhëve dhe alfabetëve

Dispozitat e Ligjit për përdorim të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë edhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale, në mënyrë përkatëse zbatohet gjatë mbikëqyrjes inspektuese."

Neni 5

Në nenin 13 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Inspektoratet janë organe në përbërje të ministrive me cilësinë e personit juridik, kanë llogari të tyre buxhetore si shfrytëzues buxhetorë të vijës së parë, në mënyrë të pavarur zbatojnë procedura për punësim në pajtim me ligjin dhe vendosin për të drejtat dhe obligimet e marrëdhënies së punës."

## Neni 6

Në nenin 14 paragrafi 2 pika shlyhet dhe shtohen fjalët: "(në tekstin e mëtejshëm: personi udhëheqës i shërbimit inspektues)."

## Neni 7

Neni 15 ndryshohet si vijon:

"(1) Drejtori harton propozim-program vjetor për punën e shërbimit inspektues dhe këtë e dorëzon te Këshilli Inspektues, më së voni deri më 30 shtator në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(2) Kryetari i Këshillit Inspektues detyrohet të konvokojë mbledhje dhe ta paraqesë në shqyrtim propozim-programin vjetor për punën e shërbimit inspektues nga paragrafi (1) të këtij neni dhe të japë mendim në drejtim të harmonizimit të programit vjetor më së voni deri më 30 nëntor në vitin rrjedhës.

(3) Drejtori, e miraton programin vjetor për punën e shërbimit inspektues në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të mendimit nga paragrafi (2) të këtij neni, përkatësisht më së voni deri më 10 dhjetor në vitin rrjedhës nëse nuk merr mendim në afatin e paraparë në paragrafin (2) të këtij neni.

(4) Në bazë të programit vjetor të miratuar të punës së shërbimit inspektues, drejtori përgatit plane tremujore për punën e secilit inspektor, të cilat të përmbledhura i dorëzon në shqyrtim te Këshilli Inspektues më së voni dy javë para fillimit të tremujorit të ardhshëm kalendarik si vijon, deri më 15 dhjetor për tremujorin e parë të vitit të ardhshëm, deri më 15 mars për tremujorin e dytë, deri më 15 qershor për tremujorin e tretë, përkatësisht deri më 15 shtator për tremujorin e katër në vitin rrjedhës.

(5) Në planet tremujore për punën e secilit inspektor, drejtori detyrimisht e fut numrin e mbikëqyrjeve të planifikuara në tre muajt e ardhshëm, si dhe shkallën e ndërlikimit të secilës mbikëqyrje.

(6) Në bazë të planeve tremujore për punën e secilit inspektor, drejtori përgatit plan mujor për punë, i cili përmban edhe orar të mbikëqyrjeve me datë dhe me subjekte të mbikëqyrjes.

(7) Drejtori, më së voni dy javë nga fillimi i tremujorit të ardhshëm kalendarik, te Këshilli Inspektues dorëzon raportet tremujore përmbledhëse për punën e secilit inspektor si vijon, deri më 15 janar për tremujorin e katërt nga viti paraprak, deri më 15 prill për tremujorin e parë, deri më 15 korrik për tremujorin e dytë, përkatësisht deri më 15 tetor për tremujorin e tretë në vitin rrjedhës.

(8) Drejtori, më së voni deri më 1 mars në vitin rrjedhës te Këshilli Inspektues dorëzon Raport vjetor për punën e shërbimit inspektues për vitin paraprak.

(9) Kryetari i Këshillit Inspektues detyrohet që planet e miratuara tremujore për punë nga paragrafi (4) të këtij neni dhe raportet tremujore për punë nga paragrafi (7) të këtij neni t'i vë në shqyrtim, të përgatitë informatë për punën e shërbimeve inspektuese dhe ta dorëzojë në Qeveri më së voni dy muaj pas kalimit të tremujorit.

(10) Për shërbimet inspektuese të organizuara si njësi organizative në kornizat e organeve të administratës shtetërore, funksionari i organit të administratës shtetërore i ka të drejtat dhe obligimet nga paragrafët (1), (3), (4), (6), (7) dhe (8) të këtij neni.

(11) Për shërbimet inspektuese të organizuara si njësi organizative në kornizat e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe qytetit të Shkupit, kryetari i komunës miraton Program vjetor për punën e shërbimeve inspektuese më së voni deri më 15 dhjetor në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(12) Formën dhe përmbajtjen e Programit nga paragrafi (1), planet nga paragrafët (4) dhe (6) dhe raportet nga paragrafët (7) dhe (8) të këtij neni, në propozim të Këshillit Inspektues, i përcakton ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës."

Neni 8

Neni 16 ndryshohet si vijon:

"(1) Këshilli Inspektues është organ i pavarur shtetëror me cilësinë e personit juridik, formohet për zbatimin e fushëveprimit të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Këshilli Inspektues ka llogari personale buxhetore, paraqet shfrytëzues buxhetor të vijës së parë, në mënyrë të pavarur zbaton procedura për punësim në pajtim me ligjin dhe vendos për të drejtat dhe obligimet e marrëdhënies së punës.

(3) Këshilli Inspektues ka shërbim profesional - administrativ, të cilin e udhëheq Sekretari i Përgjithshëm në mënyrë që siguron punë ligjore, profesionale, me përgjegjësi, në kohë dhe ekonomike.

(4) Për të punësuarit në shërbimin profesional - administrativ zbatohen dispozitat e ligjit me të cilin rregullohen të drejtat dhe obligimet e nëpunësve shtetërorë.

(5) Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Inspektues, punësimi në shërbimin profesional - administrativ dhe zgjedhja e anëtarëve të trupave të punës bëhet në bazë të kriterëve të profesionalizmit dhe kompetencës dhe në pajtim me parimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të bashkësive.

(6) Organizimi i Këshillit Inspektues, si dhe vendet e punës, punët dhe detyrat e të punësuarve përcaktohen me aktet për organizim dhe sistematizim të brendshëm të vendeve të punës, të cilat në propozim të Këshillit Inspektues i miraton Qeveria.

(7) Këshilli Inspektues ka vulë, logo, ueb faqe dhe numër telefonik falas ku lajmërohen parregullsitë, mangësitë, veprimi jo me kohë apo korrupsioni lidhur me punën e inspektorëve dhe shërbimeve inspektuese.

(8) Këshilli Inspektues përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë që funksionin e ushtrojnë në mënyrë profesionale.

(9) Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Inspektues i zgjedh, nëpërmjet konkursit publik dhe i shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(10) Kryetari i Këshillit Inspektues e ka cilësinë e organit udhëheqës, kurse këtë në mungesë të tij e zëvendëson njëri nga anëtarët e Këshillit që është i autorizuar nga kryetari.

(11) Kryetar i Këshillit Inspektues zgjidhet personi që:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë, që dëshmohet me dëshmi për shtetësi,
- ka fituar së paku 300 kredi sipas SETK apo ka mbaruar shkallën VII/1 nga sfera e shkencave juridike apo ekonomike, që dëshmohet me certifikatë,
- ka së paku gjashtë vjet përvojë pune në profesion pas diplomimit, që dëshmohet me vërtetim për përvojën e punës të lëshuar nga organi kompetent,
- në mënyrë aktive e njeh gjuhën angleze,
- shfrytëzon programe kompjuterike për punën në zyrë dhe
- është adekuat për vendin udhëheqës të punës.

(12) Anëtarët e Këshillit Inspektues zgjidhen në sferat në vijim:

- një anëtar nga sfera e mbikëqyrjes së tregut, marrëdhënieve të punës dhe sigurisë dhe shëndetit gjatë punës,
- një anëtar i Këshillit Inspektues nga sfera e mjedisit jetësor dhe mbrojtjes së shëndetit të njerëzve,
- një anëtar i Këshillit Inspektues nga sfera e ndërtimtarisë, urbanizimit, transportit,
- një anëtar i Këshillit Inspektues nga sfera e bujqësisë, pylltarisë, veterinarisë dhe sigurisë së ushqimit,
- një anëtar i Këshillit Inspektues nga sfera e arsimit, shkencës dhe kulturës dhe
- një anëtar i Këshillit Inspektues nga sfera e administratës.

(13) Anëtar i Këshillit Inspektues zgjidhet personi, i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë, që dëshmohet me dëshmi për shtetësi,

- ka fituar së paku 300 kredi sipas SETK apo ka mbaruar shkallën VII/1 dhe së paku pesë vjet përvojë pune pas diplomimit në sferën përkatëse për të cilën emërohet në pajtim me paragrafin (10) të këtij neni, që dëshkohet me certifikatë dhe vërtetim për përvojë pune në sferën përkatëse, të lëshuar nga organi kompetent,

- në mënyrë aktive e njeh gjuhën angleze,
- shfrytëzon programe kompjuterike për punën në zyrë dhe
- është adekuat për vendin udhëheqës të punës.

(14) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Inspektues zgjidhen për ushtrues detyre për periudhë prej tre muajsh, periudhë për të cilën detyrohen t'i dorëzojnë dëshmitë si vijojnë:

- njërën nga certifikatat vijuese të njohura ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze:

1) TOEFEL (TOEFEL) - edhe atë për IBT së paku 74 pikë, CBT së paku 203 pikë, PBT së paku 537 pikë;

2) IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë;

3) ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2);

4) FCE (FCE) (Cambridge English: First) - i dhënë;

5) BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë;

6) ALTE (ALTE) - së paku niveli 3 ose

- cilëndo qoftë certifikatë tjetër në nivelin B2 (B2) të Kornizës Gjuhësore Evropiane të Këshillit të Evropës (CEFR), të lëshuar nga testuesi, anëtar i shoqatës ALTE të testuesve evropianë,

- njërën nga certifikatat e njohura ndërkombëtarisht për shfrytëzimin e programeve kompjuterike për punë të zyrës:

1) Certiport: IC3 GS4 Key Applications - i dhënë;

2) Microsoft: MOS Word ose MOS Excell - i dhënë ose

3) ECDL: Core - i dhënë;

- mendim për përshtatshmëri për vendin udhëheqës të punës, përmes dhënies së testit psikologjik me elemente të integritetit, në Agjencinë për Administratë.

(15) Pas dorëzimit të dëshmimeve në afatin nga paragrafi (13) i këtij neni, ushtruesit e detyrës nga paragrafët (10) dhe (12) të këtij neni, zgjidhen për Kryetar dhe anëtarë të Këshillit Inspektues me mandat prej tri vitesh me të drejtë rizgjedhjeje, në të kundërtën u ndërpritet funksioni.

(16) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Inspektues nuk mund të jenë anëtarë në organet dhe trupat që i zgjedh ose emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ose Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(17) Koeficienti për rrogë për Kryetarin dhe anëtarët e këshillit inspektues është 3.9."

#### Neni 9

Pas nenit 16 shtohet nen i ri 16-a, si vijon:

#### "Fushëveprimi i punës të Këshillit Inspektues

#### Neni 16-a

(1) Fushëveprimi i punës të Këshillit Inspektues është:

- 1) koordinimi i punës së shërbimeve inspektuese;
- 2) formimi dhe udhëheqja me trupa punues;
- 3) përgatitja dhe ndjekja e zbatimit të metodologjive dhe procedurave për punën e shërbimeve inspektuese;
- 4) shqyrtimi dhe dhënia e mendimit për programe vjetore për punën e shërbimeve inspektuese;

- 5) shqyrtimi i çështjeve lidhur me punën e shërbimeve inspektuese;
  - 6) ndjekja e realizimit të programeve vjetore për punë, realizimi i buxheteve, numri dhe cilësia e mbikëqyrjeve të kryera nga shërbimet inspektuese përmes raporteve tremujore për punën të cilat i dorëzojnë shërbimet inspektuese;
  - 7) ndjekja e vazhdueshme e suksesit të inspektorëve;
  - 8) dhënie pëlqimi për aktet për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të shërbimeve inspektuese, të cilat nuk mund të miratohen pa të;
  - 9) dhënia e mendimit sipas ligjeve, akteve nënligjore dhe rregullave tjera nga sfera e mbikëqyrjes inspektuese;
  - 10) miratimi dhe zbatimi i programeve vjetore për aftësimin dhe përsosjen e inspektorëve në shërbimet inspektuese adekuate;
  - 11) miratimi i Programit për provim për inspektor dhe realizimi i provimit për inspektor;
  - 12) lëshimi dhe heqja e licencës për inspektorë;
  - 13) udhëheqja e procedurës disiplinore kundër inspektorëve;
  - 14) dhënia e mendimit për propozim-buxhetin e shërbimeve inspektuese;
  - 15) ndjekja e ekipimit kadrovik dhe teknik të shërbimeve inspektuese;
  - 16) furnizimi dhe përcjellja e implementimit të zgjidhjes së softuerit për shërbime inspektuese me ndarje elektronike të mbikëqyrjeve sipas inspektorëve, futja e shkallëve të ndërlikueshmërisë së mbikëqyrjeve, ndjekja e realizimit të mbikëqyrjeve dhe gjenerimi i procesverbaleve dhe zgjidhjeve, ndjekja e suksesit dhe gjenerimi i vlerësimeve vjetore për inspektorët, gjenerimi i planeve tremujore dhe mujore, raportet tremujore dhe vjetore dhe lloje tjera të raporteve, për çdo shërbim inspektues (në tekstin e mëtuftjeshëm: sistemi elektronik për shërbim inspektues);
  - 17) udhëheqja e regjistrave me interes të Këshillit inspektues;
  - 18) miratimi i Kodeksit Etik të Inspektorëve dhe
  - 19) bashkëpunimi ndërkombëtar nga sfera e mbikëqyrjes inspektuese.
- (2) Kryetari i Këshillit Inspektues në afat prej tri ditësh i lëshon urdhëresë për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese mbi punën e subjektit të caktuar të mbikëqyrjes drejtorit të inspektoratit, përkatësisht personit udhëheqës të shërbimit inspektues në rastet vijuese:
- me kërkesë të Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë si organ i shkallës së dytë, kur kjo është e nevojshme për konstatimin e plotë të gjendjes faktike,
  - me iniciativë të arritur për mbikëqyrje në Këshillin Inspektues dhe
  - me detyrë zyrtare kur ka nevojë për zbatimin e mbikëqyrjes së koordinuar inspektuese nga ana e më shumë shërbimeve inspektuese.
- (3) Nëse drejtori i inspektoratit, përkatësisht personi udhëheqës i shërbimit inspektues nuk vepron sipas urdhrit nga paragrafi (2) i këtij neni në afat prej tri ditë pune, Këshilli Inspektues mund t'ia lëshojë urdhëresën drejtpërdrejtë inspektorit dhe të ngrejë procedurë për shkarkimin e drejtorit të inspektoratit, përkatësisht të propozojë ngritje të procedurës disiplinore kundër personit udhëheqës të shërbimit inspektues i cili funksionon si njësi organizative në kuadër të organit të administratës shtetërore.
- (4) Anëtarët e Këshillit Inspektues janë të detyruar që ta njoftojnë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë se Kryetari i Këshillit Inspektues nuk ka lëshuar urdhëresë për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni në afat prej tri ditësh nga dita e të kuptuarit.
- (5) Fushëveprimi i punës së Këshillit Inspektues ka të bëjë me inspektoratet dhe shërbimet inspektuese të organizuara si njësi organizuese në kuadër të organeve tjera të administratës shtetërore.
- (6) Kryetari i këshillit inspektues konvokon mbledhje të trupave punues të Këshillit Inspektues, me iniciativë të tij, iniciativë të anëtarit të Këshillit Inspektues, të drejtorit të inspektoratit përkatësisht, personit udhëheqës të shërbimit inspektues, ose të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe udhëheq me mbledhjet.

(7) Trupat punues në kuptim të paragrafit (5) të këtij neni janë:

- trupi punues për përcaktimin e efektivitetit, efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve inspektuese në të cilin marrin pjesë anëtarët e Këshillit Inspektues dhe Drejtorët e inspektorateve dhe

- trupi punues për arsim, përsosje dhe trajnim në të cilin marrin pjesë anëtarët e Këshillit Inspektues dhe Drejtorët e inspektorëve.

(8) Përveç trupave punues nga paragrafi (7) i këtij neni, Këshilli Inspektues mund të formojë edhe trupa tjerë punues, kur do të ketë nevojë për këtë.

(9) Kryetari i Këshillit Inspektues mund të ftojë vetëm disa prej anëtarëve të trupave punues nga paragrafët (7) dhe (8) i këtij neni, si dhe përfaqësues të shërbimeve tjera inspektuese, si dhe të publikut shkencor dhe profesional, varësisht nga rendi i ditës i mbledhjes.

(10) Këshilli Inspektues detyrimisht së paku njëherë në muaj mban mbledhje në të cilën debaton veç e veç për të gjitha parashtrësuarat dhe ankesat e parashtruara nga qytetarët dhe personat juridikë për punën e inspektorëve dhe shërbimeve inspektuese dhe për çdo parashtrësuar dhe ankesë të bazuar miraton vendim, më së shumti në afat prej 30 ditësh.

(11) Mbledhja e Këshillit Inspektues nga paragrafi (10) i këtij neni është publike.

(12) Këshilli Inspektues për punën e tij miraton rregullore.

(13) Këshilli Inspektues vendos në mbledhje me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, ndërsa vendimet e Këshillit Inspektues i nënshkruan Kryetari.

(14) Këshilli Inspektues miraton Program vjetor për punë më së voni deri më 15 dhjetor në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(15) Këshilli Inspektues për punën e tij dhe për punën e shërbimeve inspektuese e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë katër herë në vit dhe sipas nevojës.

(16) Llojin, formën dhe përmbajtjen e regjistrave nga paragrafi (1) alineja 18 të këtij neni, me propozim të Këshillit Inspektues i përcakton ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(17) Mbikëqyrje mbi punën e Këshillit Inspektues kryen Inspektorati Shtetëror Administrativ, për çfarë e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë katër herë në vit dhe sipas nevojës."

#### Neni 10

Titulli para nenit 18 dhe neni 18 ndryshohen si vijojnë:

"Inspektorët dhe kushtet për ushtrimin  
e detyrës inspektor

#### Neni 18

(1) Për çështje që kanë të bëjnë me punësimin, të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës të inspektorëve që nuk janë rregulluar me këtë ligj, do të zbatohen dispozitat e ligjit me të cilin rregullohen të drejtat dhe detyrat e nëpunësve shtetërorë.

(2) Inspektorët janë të autorizuar të zbatojnë procedura dhe punë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjet që i rregullojnë llojet e caktuara të mbikëqyrjes inspektuese.

(3) Kushtet për kryerjen e detyrës inspektor të përcaktuara me këtë ligj kanë të bëjnë me inspektorët e punësuar në inspektoratet dhe shërbimet inspektuese të organizuara si njësi organizuese në kuadër të organeve tjera të administratës shtetërore.

(4) Inspektor mund të jetë personi i cili:

- i përmbush kushtet e përgjithshme të përcaktuara me ligjin me të cilin rregullohen të drejtat dhe detyrat e nëpunësve shtetërorë ose me ligj tjetër,

- i përmbush kushtet e veçanta të përcaktuara me ligj dhe me aktin për sistematizim të vendeve të punës në shërbimin inspektues,

- posedon certifikatë të njohur ndërkombëtarisht për punën me programe kompjuterike për punë të zyrës, dhe atë një nga certifikatat në vijim:

- 1) Certiport: IC3 GS4 Key Applications - i dhënë;
  - 2) Microsoft: MOS Word ose MOS Excell - i dhëne ose
  - 3) ECDL: Core - i dhënë;
- të ketë marrë mendim pozitiv për përshtatshmëri për vendin e punës me dhënie të testit psikologjik dhe testit të integritetit, në Agjencinë për Administratë dhe
- të ketë licencë për inspektor nga sfera e kompetencës së shërbimit inspektues.
- (5) Inspektorit i cili gjatë kryerjes së punës është i ekspozuar ndaj rrezikut për jetë dhe shëndet mund t'i jepet shtesë rroge, varësisht nga lloji i rrezikut, në lartësi prej 10% deri 30% nga shuma e rrogës bazë dhe shtesa e rrogës për titull.
- (6) Vendet e punës si dhe lartësinë e shumës nga paragrafi (6) i këtij neni, i përcakton Këshilli Inspektues."

#### Neni 11

Titulli para neni 19 dhe neni 19 ndryshohen si vijojnë:

"Licenca për inspektor

#### Neni 19

- (1) Për marrjen e licencës për inspektor nga sfera adekuate e shërbimit inspektues (në tekstin e mëtutjeshëm: licenca për inspektor), kandidati jep provim për inspektor.
- (2) Kushti për dhënie e provimit për inspektor është që kandidati të ketë së paku pesë vjet përvojë pune në sferën përkatëse të shërbimit inspektues pas diplomimit.
- (3) Provimi realizohet në pajtim me programin për provim për inspektor, të cilin me propozim të drejtorit të inspektoratit, përkatësisht personit udhëheqës të shërbimit inspektues e miraton Këshilli Inspektues.
- (4) Provimi realizohet së paku tri herë gjatë një viti kalendarik për çdo sferë të shërbimeve inspektuese.
- (5) Provimin për inspektor e realizon edhe licencën për inspektor e jep Këshilli Inspektues.
- (6) Licenca nga paragrafi (1) i këtij neni, ka vlefshmëri prej gjashtë vitesh.
- (7) Para skadimit të vlefshmërisë së licencës, inspektori përsëri jep provim për inspektor.
- (8) Provimin nga paragrafi (7) i këtij neni inspektori e jep gjatë vitit të fundit të vlefshmërisë së licencës ekzistuese.
- (9) Provimin nga paragrafi (7) i këtij neni inspektori ka të drejtë ta japë tri herë, e më së voni deri në skadimin e vlefshmërisë së licencës ekzistuese.
- (10) Nëse inspektori nuk e jep provimin për inspektor në tentimin e tretë dhe skadon vlefshmëria e licencës ekzistuese, i ndërpritet marrëdhënia e punës.
- (11) Mënyrën e dhënies së provimit për inspektor si dhe formën e përmbajtjes së kërkesës për dhënie e provimit dhe licencës për inspektor, me propozim të Këshillit Inspektues, i përcakton ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës."

#### Neni 12

Pas neni 19 shtohen dhjetë tituj të rinj dhe dhjetë nene të reja: 19-a, 19-b, 19-v, 19-g, 19-d, 19-gj, 19-e, 19-zh, 19-z dhe 19-x, si vijojnë:

"Heqja e licencës për inspektor

#### Neni 19-a

- (1) Këshilli Inspektues është i detyruar të miratojë aktvendim me të cilin inspektorit do t'ia heqë licencën e inspektorit, në rast se konstaton se:
  - e humb aftësinë e punës me ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotfuqishëm për konstatimin e aftësisë së humbur të punës,

- i ndërpritet shtetësia e Republikës së Maqedonisë, me ditën e dorëzimit të aktvendimit për heqje të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë,

- është i akuzuar për vepër penale lidhur me detyrën zyrtare e cila e bën të padenjë për inspektor dhe për kryerjen e punëve në shërbimin inspektues, me ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit,

- i është shqiptuar dënimi ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, me ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit,

- për shkak të vuajtjes së dënimit me burg në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj, me ditën e fillimit të vuajtjes së dënimit dhe

- i mbush 64 vjet.

(2) Këshilli Inspektues mund të miratojë aktvendim me të cilin inspektorit përkohësisht do t'ia heqë licencën ose licencën e përkohshme për inspektor dhe të ngrejë procedurë disiplinore në rast se konstaton se inspektori:

- në mënyrë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme e kryen punën e inspektorit,

- është vlerësuar me notë vjetore "pamjaftueshëm",

- sillet në mënyrë të pahijshme, fyese dhe të dhunshme gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të punës,

- refuzon t'u japë ose u jep të dhëna të pasakta Këshillit Inspektues, shërbimeve inspektuese, përkatësisht palëve,

- në mënyrë të paligjshme disponon me mjete materiale të shërbimeve inspektuese,

- refuzon të veprojë sipas urdhrorit për kryerjen e mbikëqyrjes të dhënë nga Këshilli Inspektues,

- nuk e respekton Kodeksin Etik të inspektorëve,

- e keqpërdor statusin e inspektorit për dobi personale ose materiale,

- i keqpërdor të dhënat personale të subjektit të mbikëqyrjes ose jep informata të klasifikuara me shkallë të sekretit të përcaktuar me ligj dhe

- punon nën ndikimin e alkoolit ose mjeteve narkotike.

(3) Për rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, drejtori i inspektoratit, funksionari i cili udhëheq me organin, përkatësisht personi udhëheqës i shërbimit inspektues është i detyruar qëta njoftojë Këshillin Inspektues, në afat prej shtatë ditësh nga dita e të kuptuarit se kanë ndodhur.

(4) Në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni, Kryetari, anëtari i Këshillit Inspektues, Drejtori i inspektoratit, funksionari i cili udhëheq me organin, përkatësisht personi udhëheqës i shërbimit inspektues është i detyruar të kërkojë ngritje të procedurës disiplinore në Këshillin Inspektues, në afat prej tre deri në gjashtë muaj nga dita e të kuptuarit të shkeljes së kryer, por jo më gjatë se tre vjet nga dita e kryerjes së shkeljes.

#### Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të inspektorit

##### Neni 19-b

(1) Kërkesa për ngritjen e procedurës disiplinore nga neni 19-a paragrafi (2) të këtij ligji, i dorëzohet Këshillit Inspektues dhe i përmban emrin dhe mbiemrin e inspektorit, adresën dhe vendbanimin, numrin amë, në cilin shërbim inspektues është i punësuar, përshkrimin e shkeljes disiplinore dhe emërtimin ligjor të shkeljes. Me kërkesë dorëzohen edhe dëshmitë në të cilat bazohet kërkesa.

(2) Për zbatimin e procedurës disiplinore nga neni 19-a paragrafi (2) i këtij ligji, Këshilli Inspektues me aktvendim formon komision disiplinor të përbërë nga një përfaqësues i Agjencisë për Administratë, një anëtar nga radhët e të punësuarve në shërbimin inspektues në të cilin është i punësuar inspektori kundër të cilit është ngritur procedurë disiplinore, si dhe një anëtar nga radhët e inspektorëve udhëheqës në cilindo shërbim tjetër inspektues. Me komisionin disiplinor kryeson anëtari i komisionit disiplinor nga radhët e inspektorëve udhëheqës në shërbimin tjetër inspektues.



(3) Komisioni Disiplinor ia dorëzon kërkesën dhe dëshmitë inspektorit kundër të cilit është parashtruar. Inspektori mundet me shkrim të përgjigjet në pohimet e kërkesës dhe t'i dorëzojë dëshmitë e tij ose të japë deklaratë me gojë në procesverbal në afat prej pesë ditësh nga marrja e kërkesës.

(4) Komisioni Disiplinor nga paragrafi (2) i këtij neni me kërkesë merr të dhëna dhe dëshmi plotësuese që janë me interes për konstatimin e gjendjes në lidhje me përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të inspektorit dhe është i detyruar që të miratojë vendim pas ngritjes së procedurës disiplinore në afat prej 20 ditësh nga dita e ngritjes së procedurës.

(5) Për punën e tij anëtarët e komisionit disiplinor marrin kompensim adekuat. Lartësinë e kompensimit e përcakton Këshilli Inspektues.

(6) Aktvendimi nga neni 19-a paragrafi (2) të këtij ligji, do të vlejë gjatë kohëzgjatjes së procedurës disiplinore.

(7) Nëse pas procedurës së ngritur disiplinore nga neni 19-a paragrafi (2) të këtij ligji është shqiptuar masë disiplinore, inspektori ka të drejtë kundërshtimi në Këshillin Inspektues.

(8) Këshilli Inspektues vendos për kundërshtimin e parashtruar të inspektorit në afat prej tri ditësh nga dita e parashtrimit.

(10) Nëse Këshilli Inspektues e vërteton vendimin e Komisionit Disiplinor, ai miraton aktvendim me të cilin do t'ia heqë licencën inspektorit.

(11) Nëse komisioni disiplinor, përkatësisht Këshilli Inspektues nuk gjen përgjegjësi disiplinore, Këshilli Inspektues me aktvendim e revokon aktvendimin për heqje të përkohshme të licencës.

(12) Kundër aktvendimit për heqje të licencës për inspektor nga paragrafët (1) dhe (10) të këtij neni inspektori ka të drejtë të parashtrtojë padi në Gjykatën Administrative.

(13) Inspektorit të cilit i është hequr licenca për inspektor, i ndërpritet marrëdhënia e punës.

(14) Inspektori të cilit i është hequr licenca në pajtim me paragrafin (10) të këtij neni mundet përsëri të japë provim, si dhe të marrë licencë të re pas skadimit të tre viteve nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, nëse i përmbush kushtet e përcaktuara me ligj.

(15) Ekzemplari nga aktvendimi për heqje, heqje të përkohshme të licencës, përkatësisht për revokimin e aktvendimit për heqje të përkohshme të licencës, menjëherë i dorëzohet inspektorit dhe shërbimit inspektues në të cilin punon inspektori.

## Provimi për inspektor

### Neni 19-v

(1) Provimi për inspektor jepet për kontroll të aftësive profesionale të kandidatëve për kryerje të pavarur të mbikëqyrjes inspektuese, si dhe njohjes dhe zbatimit të rregullave nga fushëveprimi i punës së shërbimit inspektues.

(2) Provimi për inspektor përbëhet prej dy pjesëve, si vijon:

- pjesa e parë (pjesa teorike), me të cilën kontrollohet njohuria teorike e kandidatëve dhe
- pjesa e dytë (studimi i rastit), me të cilin kontrollohet aftësia për zbatim të ligjeve në praktikë.

(3) Provimi nga paragrafi (1) i këtij neni jepet me shkrim në formë elektronike, me përgjigje të numrit të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(4) Pjesa e parë e provimit jepet në sferat:

- procedura e përgjithshme administrative,
- procedura inspektuese,
- procedura për kundërvajtje dhe
- procedura e veçantë nga sfera e shërbimit inspektues për të cilin jepet licencë për inspektor.

(5) Pjesa e dytë e provimit përbëhet nga:

- përshkrimi i dy studimeve të rastit nga sfera e shërbimit inspektues për të cilin jepet licenca për inspektor dhe

- pyetje të cilave kandidati duhet t'u përgjigjet në bazë të analizës së rasteve e të cilat dalin nga procedura e veçantë nga sfera e shërbimit inspektues për të cilin jepet licenca për inspektor.

(6) Provimin e realizon Këshilli Inspektues, në lokal për dhënie të provimit, me pajisje të veçantë për dhënie të provimit profesional me pajisje materiale-teknike dhe informatike, lidhje interneti dhe pajisje për incizim të dhënies së provimit.

(7) Dhënia e provimit incizohet dhe emetohet drejtpërdrejt në ueb faqen e Këshillit Inspektues, e nëse për shkaqe teknike ndërpritet incizimi, incizimi i gjithë provimit vendoset në ueb faqen e Këshillit Inspektues.

(8) Kandidatit gjatë dhënies së pjesë së parë të provimit nuk i lejohet shfrytëzimi i ligjeve, ligjeve me komentim dhe sqarim, celularit, mjeteve portative kompjuterike dhe mjeteve tjera teknike dhe informatike, sende paraprakisht të përgatitura dhe ngjashëm.

(9) Kandidatit gjatë kohës së dhënies së pjesës së dytë të provimit, i lejohet shfrytëzimi vetëm i ligjeve (pa komente dhe sqarime) të cilat në versionin elektronik gjenden në kompjuter në të cilin kandidati e jep provimin.

(10) Kandidatit gjatë kohës së dhënies së provimit të pjesës së parë dhe të dytë nuk i lejohet të kontaktojë me kandidatë tjerë ose persona përveç me informatikan të punësuar në Këshillin Inspektues, nëse ka probleme teknike me kompjuterin.

(11) Nëse problemet teknike me kompjuterin mënjanohen për pesë minuta provimi vazhdon, e nëse nuk mënjanohen në këtë afat i njëjti vetëm për atë kandidat ndërpritet dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

(12) Nëse kandidati gjatë dhënies së provimit të pjesës së parë dhe të dytë vepron në kundërshtim me paragrafët (7), (8) dhe (9) të këtij neni, nuk do t'i lejohet dhënie e mëtejshme e provimit.

#### Pyetjet e provimit

##### Neni 19-g

(1) Këshilli inspektues e formon bazën e pyetjeve për pjesën e parë dhe bazën e studimeve të rastit të pjesës së dytë të provimit nga neni 19-v të këtij ligji.

(2) Për përpilimin e pyetjeve të pjesës së parë dhe pyetjet e studimeve të rastit të pjesës së dytë të provimit, Këshilli inspektues angazhon edukatorë.

(3) Edukator mund të jetë personi i cili ka arsim të lartë dhe dhjetë vjet përvojë punë në sferën e kompetencës së shërbimit inspektues për të cilin ka të bëjë provimi.

(4) Këshilli inspektues bënë azhurnimin e bazës së pyetjeve nga neni 19-v të këtij ligji, së paku një herë në vit.

(5) Këshilli inspektues kryen ndryshime të së paku 30% të studimeve të rastit nga baza e studimeve të rastit çdo vit.

(6) Gjatë azhurnimit nga paragrafi (4) të këtij neni Këshilli Inspektues veçanërisht i ka parasysh ndryshimet e rregullave juridike në të cilat është bazuar çështja, përkatësisht rasti, numrin e kandidatëve të cilët janë përgjigjur, suksesin në përgjigjet e të njëjtave.

#### Dhënia e provimit

##### Neni 19 - d

(1) Pjesa e parë e provimit jepet në secilën prej lëndëve të numëruara në nenin 19 -v paragrafi 4 të këtij ligji dhe përmban së paku 60 pyetje me pesë opsione për zgjidhje prej të cilave njëri është i saktë, dy janë të ngjashme, njëri është i pasaktë në masë të vogël (te ai humben numër i vogël i pikëve) dhe njëri është më i pasaktë në masë të madhe (te ai humben numër më i madh i pikëve).

(2) Pjesa e dytë e provimit përbëhet prej dy studime të rastit të bazuara në lëndët e theksuara në nenin 19-v paragrafi (4) alinetë 1, 2 ose 3 të këtij ligji (studimi i parë) dhe nenit 19-v paragrafi (4) alineja 4 të këtij ligji (studimi i dytë).

(3) Pyetjet që janë pjesë përbërëse e studimeve të rastit janë nga sfera e lëndës në të cilën bazohet studimi i rastit dhe kanë dhjetë opsione të mundshme të përgjigjeve prej të cilave njëri është i saktë, pesë janë të ngjashme dhe katër janë të ndryshme.

(4) Provimi për inspektor do të llogaritet se është kaluar nëse nga numri i përgjithshëm i pikëve kandidati ka marrë më shumë se 70%.

#### Mënyra e dhënies së provimit

##### Neni 19 - gj

(1) Dhënia e pjesës së parë të provimit për inspektor bëhet me përgjigjen e pyetjeve.

(2) Dhënia e pjesës së dytë të provimit për inspektor bëhet me studimin e studimeve të rastit dhe përgjigjen e numrit të caktuar të pyetjeve të cilat dalin nga studimet.

(3) Pyetjet e testit dhe studimet e rastit, varësisht nga pesha, vlerësohen me numër të caktuar të pikëve.

(4) Pyetjet e përfshira në tekstet për dhënien e pjesës së parë të provimit për inspektor dhe përgjigjet e tyre, si dhe studimet e rastit dhe përgjigjet të cilat dalin nga studimet dhe përgjigjet e tyre ruhen në sistemin unik elektronik për dhënien e provimit të inspektorit.

(5) Sistemi elektronik nga paragrafi (4) i këtij neni përmban edhe bazë publikisht të kapshme prej së paku 2 000 pyetjesh për nevojat e pjesës së parë të provimit, si dhe bazë publikisht të kapshme prej së paku 200 studimeve të rastit për nevojat e pjesës së dytë të provimit.

(6) Në sistemin elektronik përmbahet edhe udhëzim për rregullat dhe literaturën juridike në të cilat përmbahen përgjigjet e pyetjeve nga pjesa e parë e provimit dhe rregullat për pjesën e dytë të provimit.

(7) Rezultatet nga dhënia e pjesës së parë dhe të dytë të provimit kandidati i ka të kapshme në kompjuterin në të cilin e ka dhënë provimin, menjëherë pas përfundimit të tij.

(8) Mënyrën e dhënies së provimit për inspektor, me propozim të Këshillit Inspektues, e përcakton ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

#### Ndjekja e vazhdueshme e suksesit të inspektorëve

##### Neni 19-e

(1) Këshilli Inspektues, drejtori, përkatësisht personi udhëheqës i shërbimit të inspektimit vazhdimisht e ndjekin suksesin e inspektorëve.

(2) Qëllimi i ndjekjes së suksesit të inspektorëve është përforcimi i motivimit personal të inspektorëve, përforcimi i efikasitetit dhe profesionalizmit gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, si dhe mundësia për avancim profesional në shërbim.

(3) Si pjesë e procesit të ndjekjes së suksesit të inspektorëve, drejtori i inspektoratit, përkatësisht personi udhëheqës i shërbimit të inspektimit, më së voni deri në fund të muajit janar në vitin rrjedhës për vitin e kaluar bën vlerësim vjetor të suksesit të inspektorëve.

(4) Vlerësimi vjetor i suksesit të inspektorit bëhet në bazë të kriterëve kuantitative të cilat janë pjesë e planit tremujor për punë dhe raportit tremujor për punën e inspektorit, si dhe përmes zbatimit të kriterëve kualitative për sukses të inspektorit, dhe i njëjti regjistrohet në Formularin për vlerësimin vjetor për suksesin e inspektorit (në tekstin e mëtejshëm: Formular për vlerësimin vjetor).

(5) Formën dhe përmbajtjen e Formularit për vlerësimin vjetor, me propozim të Këshillit Inspektues, e përcakton ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

## Kriteret kuantitative për suksesin e inspektorëve

### Neni 19-zh

(1) Kriteret kuantitative për suksesin e inspektorëve janë të dhënat e planit tremujor për punë dhe raportit tremujor për punën e inspektorit, në lidhje me peshën e mbikëqyrjeve të planifikuara dhe peshën e mbikëqyrjeve të kryera për secilin tremujor.

(2) Varësisht nga numri i subjekteve të cilat janë lëndë e mbikëqyrjes, vëllimi i rregullave të cilat janë lëndë e mbikëqyrjes, koha e nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes, shuma e gjobës e cila mund të shqiptohet për mangësitë e përcaktuara gjatë mbikëqyrjes, drejtori, përkatësisht personi udhëheqës i shërbimit inspektues, me pëlqimin e marrë paraprakisht nga Këshilli Inspektues, me akt intern përcakton së paku pesë koeficiente të ndërlikueshmërisë së mbikëqyrjeve.

(3) Vlera e mbikëqyrjeve të planifikuara për inspektor, për secilin tremujor llogaritet si shumë e numrit të mbikëqyrjeve të realizuara për secilin nivel të ndërlikueshmërisë me koeficientin e ndërlikueshmërisë, dhe i njëjti është dhënë në planin tremujor për punën e inspektorit.

(4) Vlera e mbikëqyrjeve të planifikuara për inspektor, për secilin tremujor llogaritet si shumë e numrit të mbikëqyrjeve të realizuara për secilin nivel të ndërlikueshmërisë të shumëzuar me koeficientin e ndërlikueshmërisë, dhe i njëjti është dhënë në planin tremujor për punën e inspektorit.

(5) Gjatë planifikimit të mbikëqyrjeve për secilin tremujor, drejtori, përkatësisht personi udhëheqës i shërbimit të inspektimit duhet ta marrë parasysh edhe mungesën eventuale të inspektorit për shkak të shfrytëzimit të pushimit vjetor dhe në mënyrë përkatëse ta llogarisë vlerën e mbikëqyrjeve të planifikuara në planin tremujor për punën e inspektorit.

(6) Në rast të mungesës së inspektorit për shkak të pushimit mjekësor ose shkaqe tjera të arsyeshme në kohëzgjatje prej 15 deri në 45 ditë në një tremujor, vlera e mbikëqyrjeve të kryera për tërë tremujorin llogaritet si prodhim i vlerës mesatare për mbikëqyrje të realizuara për ditë në ditën e punës në të cilat inspektori ka qenë prezent, e shumëzuar me numrin e përgjithshëm të ditëve të punës në tremujor.

(7) Vlera mesatare për mbikëqyrje të kryera për ditë në ditët e punës në të cilat inspektori ka qenë prezent nga paragrafi (6) i këtij neni, llogaritet si koeficient nga vlera për mbikëqyrjet e realizuara për të gjitha ditët e punës në të cilat inspektori ka qenë prezent në punë, me numrin e ditëve të punës në të cilat inspektori ka qenë prezent në punë.

(8) Në rast të mungesës së inspektorit për shkak të pushimit mjekësor ose shkaqe tjera të arsyeshme në kohëzgjatje më shumë se 45 ditë në një tremujor, vlera e mbikëqyrjeve të kryera për tërë tremujorin llogaritet si vlerë mesatare e tre tremujorëve tjerë në të cilat inspektori ka qenë në punë..

(9) Nëse vlera e mbikëqyrjeve të realizuara për inspektor është 100% nga vlera e mbikëqyrjeve të planifikuara, e njëjta vlerësohet me 100 pikë për secilin tremujor,

(11) Nëse vlera e mbikëqyrjeve të kryera për inspektor është më e vogël ose më e madhe se vlera e mbikëqyrjeve të planifikuara, e njëjta llogaritet si herës i vlerës së mbikëqyrjeve të realizuara dhe vlerës së mbikëqyrjeve të planifikuara e shumëzuar me 100 dhe e shprehur në pikë.

(12) Numri maksimal i pikëve për suksesin kuantitativ për një tremujor mund të jetë 140.

(13) Suksesi kuantitativ i inspektorit për periudhën e një viti llogaritet si shumë e pikëve për suksesin për të katër tremujorët, me ç'rast vlera maksimale mund të jetë 560 pikë.

(14) Për inspektorin i cili së paku dy tremujorë ka munguar më gjatë se 90 ditë, Këshilli Inspektues miraton vendim për mënyrën në të cilën do të bëhet vlerësimi i suksesit të tij kuantitativ.

(15) Kriteret kuantitative për suksesin e inspektorit dhe vlerën e tyre janë pjesë e Formularit për vlerësim vjetor.

## Kritere kualitative për suksesin e inspektorëve

### Neni 19-z

(1) Kritere kualitative për suksesin e inspektorëve janë të dhënat dhe informatat e marra përmes sistemit elektronik për shërbime inspektuese ose përmes evidencës tjetër, për:

- respektimin e afateve ligjore për përpilimin e procesverbaleve dhe miratimin e aktvendimeve,

- raportin ndërmjet numrit të aktvendimeve të verifikuara ose shfuqizuara me numrin e përgjithshëm të aktvendimeve dhe

- mbajtjen e procesverbaleve dhe aktvendimeve në format elektronik, rregullshmërinë në mbajtjen e lëndëve të cilat janë në punë te inspektori dhe kualitetin e shprehjes me shkrim të inspektorit.

(2) Kriteri nga paragrafi (1) alineja 1 të këtij neni, kualiteti i punës së inspektorit në pjesës e respektimit të afateve ligjore për përpilimin e procesverbaleve dhe miratimin e aktvendimeve, për secilin vit vlerësohet në mënyrën si vijon:

- i ka respektuar afatet në 100% nga lëndët - 30 pikë,

- i ka respektuar afatet në më shumë se 75% nga lëndët - 15 pikë dhe

- i ka respektuar afatet në më pak se 75% nga lëndët - 0 pikë.

(3) Kriteri nga paragrafi (1) alineja 2 të këtij neni, vlerësohet në mënyrën si vijon:

- deri 3% - 60 pikë,

- prej 3% deri 6% - 45 pikë,

- prej 6% deri 15% - 30 pikë,

- prej 15% deri 20% - 15 pikë dhe

- më shumë se 20% - 0 pikë.

(4) Kriteri nga paragrafi (1) alineja 2 të këtij neni merret parasysh gjatë përcaktimit të suksesit kualitativ të inspektorit, kundër aktvendimeve të të cilëve janë deklaruar mjete juridike.

(5) Kriteri nga paragrafi (1) alineja 3 të këtij neni, për çdo vit vlerësohet në mënyrën si vijon:

- me kualitet të mirë - 10 pikë,

- me kualitet pjesërisht të mirë - 5 pikë dhe

- me kualitet të dobët - 0 pikë.

(6) Suksesit kualitativ i inspektorit për periudhën prej një viti llogaritet si shumë e pikëve të realizuara për paragrafët (2), (3) dhe (5) të këtij neni, me ç'rast vlera maksimale mund të jetë 100 pikë.

(7) Kriteret kualitative për suksesin e inspektorit dhe vlerën e tyre janë pjesë e Formularit për vlerësimin vjetor.

## Vlerësimi vjetor për suksesin e inspektorëve

### Neni 19-x

(1) Numri i përgjithshëm i pikëve për suksesin e inspektorit llogaritet si shumë e pikëve të suksesit kuantitativ dhe kualitativ për periudhën prej një viti, me ç'rast numri maksimal i pikëve mund të jetë 660.

(2) Varësisht nga pikët e realizuara, vlerësimi vjetor i suksesit të inspektorit mund të jetë:

- veçanërisht dallohet - mbi 600 pikë,

- dallohet - prej 500 deri 600 pikë,

- mjaftueshëm - prej 400 deri 500 pikë,

- pjesërisht mjaftueshëm - prej 300 deri 400 pikë dhe

- pamjaftueshëm - nën 300 pikë.

(3) Vlerësimi vjetor i suksesit të inspektorit shënohet në Formularin për vlerësimin vjetor, dhe i njëjti më së voni deri më 1 shkurt në vitin rrjedhës i dërgohet inspektorit.

(4) Inspektori që nuk është i kënaqur me vlerësimin nga paragrafi (3) të këtij neni, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të Formularit për vlerësimin vjetor, ka të drejtë kundërshtimit të Këshilli Inspektues.

(5) Këshilli Inspektues vendos për kundërshtimin e parashtruar të inspektorit në afat prej tetë ditësh nga data e parashtrimit.

(6) Nëse Këshilli Inspektues e pranon kundërshtimin e inspektorit dhe lëndën e kthen në veprim të sërishëm, drejtori, përkatësisht personi udhëheqës i shërbimit inspektues, në afat prej tetët ditësh duhet të veprojë sipas udhëzimeve dhe sugjerimeve të Këshillit Inspektues dhe të miratojë vendim.

(7) Drejtori, përkatësisht personi udhëheqës i shërbimit të inspektimit përpilon rang listë me vlerësimet vjetore dhe pikët e realizuara për të gjithë inspektorët në shërbimin e inspektimit.

(8) Rang lista nga paragrafi (3) të këtij neni, së bashku me formularët për vlerësimin vjetor për suksesin e të gjithë inspektorëve në shërbimin e inspektimit, dorëzohet në Këshillin Inspektues si shtojcë e Raportit vjetor për punën e shërbimit të inspektimit.

(9) Pas miratimit të Raportit vjetor për punën e shërbimit inspektues nga ana e Këshillit Inspektues, drejtori, përkatësisht personi udhëheqës i shërbimit inspektues, më së voni deri më 31 mars miraton:

- aktvendim për zmadhimin e rrogës në shumë prej 20% për periudhën prej një viti, për inspektorët të cilët vlerësohen me vlerësimin "veçanërisht dallohet",

- aktvendim për zmadhimin e rrogës në shumë prej 5% për periudhën prej një viti, për inspektorët të cilët vlerësohen me vlerësimin "dallohet",

- aktvendim për zvogëlimin e rrogës në shumë prej 20% për periudhën prej një viti, për inspektorët të cilët vlerësohen me vlerësimin "pjesërisht mjaftueshëm" dhe

- propozim për ngritjen e procedurës disiplinore të Këshilli Inspektues, për inspektorët të cilat janë vlerësuar me vlerësimin "pamjaftueshëm".

(10) Inspektorët të cilët tri vite të njëpasnjëshme janë vlerësuar me "veçanërisht dallohet" ose "dallohet", do të kenë përparësi për plotësimin e vendit të punës përmes avancimit, në procedura në pajtim me ligjin."

#### Neni 13

Titulli i nenit 20 dhe neni 20 ndryshohen si vijojnë:

"Aftësimi profesional dhe përsosja e inspektorëve

#### Neni 20

"(1) Inspektori ka të drejtë dhe detyrë që të aftësohet për realizimin e punëve të tij dhe detyrave të punës në pajtim me programin vjetor për aftësim dhe përsosje profesionale në sferën e mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Programin vjetor për aftësim dhe përsosje profesionale në sferën e mbikëqyrjes inspektuese me propozim të drejtorit të inspektoratit e miraton Këshilli Inspektues.

(3) Aftësimin dhe përsosjen profesionale nga paragrafi (1) të këtij neni e organizon Këshilli Inspektues.

(4) Aftësimin dhe përsosjen profesionale nga paragrafi (1) të këtij neni, e realizojnë edukatorët nga neni 19-v paragrafi (2) të këtij ligji.

(5) Pas çdo aftësimi dhe përsosje profesionale, inspektori detyrohet që të japë test për kontrollimin e njohurive të fituara gjatë aftësimit dhe përsosjes profesionale.

(6) Testi nga paragrafi (5) i këtij neni do të shërbejë vetëm si përgatitje për dhënien e provimit për inspektor."

#### Neni 14

Neni 21 shlyhet.

#### Neni 15

Në nenin 37 paragrafi (7) pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "e me kërkesë të subjektit të mbikëqyrjes detyrohet që në afat prej pesë ditësh t'ia dorëzojë me postë elektronike në adresën e caktuar nga subjekti i mbikëqyrjes."

#### Neni 16

Në nenin 43 paragrafi (2) fjalët: "komision i posaçëm prej tre anëtarësh të emëruar nga ministri" zëvendësohen me fjalët: "Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë".

Në paragrafin (3) fjalët: "komision i posaçëm pranë Ministrisë i përbërë prej tre anëtarëve të cilët i emëron ministri, funksionari i organit të administratës shtetërore, përkatësisht kryetari i komunës", zëvendësohen me fjalët: "Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë".

#### Neni 17

Pas neni 63 shtohen dy nene të reja 63-a dhe 63-b, si vijojnë:

### "XIII-a. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

#### Neni 63 -a

(1) Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 3000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet kryetarit të Këshillit Inspektues, nëse:

- nuk i paraqet në shqyrtim në mbledhje Programet vjetore për punën e shërbimeve inspektuese në pajtim me nenin 15 paragrafi (2) të këtij ligji,

- nuk i paraqet në shqyrtim në mbledhje të Këshillit Inspektues planet tremujore dhe raportet tremujore ose nuk dorëzon informatë në Qeveri, në pajtim me nenin 15 paragrafi (9) të këtij ligji dhe

- nuk konvokon mbledhje të Këshillit Inspektues në të cilën do të shqyrtohen parashtresat dhe propozimet e qytetarëve, e që është e hapur për publikun, së paku një herë në muaj ose nuk miraton vendime për parashtresat e bazuara në pajtim me nenin 16-a paragrafët (8) dhe (9) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 7 500 deri në 15 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet kryetarit të Këshillit Inspektues, nëse:

- me kërkesë të Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë si organ i shkallës së dytë, nuk jep urdhëresë për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në punën e subjektit të caktuar te drejtori i inspektoratit, përkatësisht personi udhëheqës zyrtar i shërbimit inspektues kur kjo është e nevojshme për përcaktimin e plotë të gjendjes faktike në pajtim me nenin 16-a paragrafi (2) alineja 1 të këtij ligji,

- pas iniciativës së ardhur për mbikëqyrje te Këshilli Inspektues nuk jep urdhëresë për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në punën e subjektit të caktuar te drejtori i Inspektoratit, përkatësisht personi udhëheqës zyrtar i shërbimit inspektues kur kjo është e nevojshme për përcaktimin e plotë të gjendjes faktike në pajtim me nenin 16-a paragrafi (2) alineja 2 të këtij ligji,

- kur ka nevojë për realizimin e mbikëqyrjes së koordinuar inspektuese nga më shumë shërbime inspektuese nuk jep urdhëresë për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në punën e subjektit të caktuar te drejtori i Inspektoratit, përkatësisht personi udhëheqës zyrtar i shërbimit inspektues kur kjo është e nevojshme për përcaktimin e plotë të gjendjes faktike në pajtim me nenin 16-a paragrafi (2) alineja 3 të këtij ligji dhe

- nuk i jep urdhëresë drejtpërdrejt inspektorit dhe nuk ngrit procedurë për shkarkimin e drejtorit të Inspektoratit, përkatësisht nuk propozon ngritje të procedurës disiplinore kundër personit udhëheqës zyrtar të shërbimit inspektues i cili funksionon si njësi organizative në kuadër të organit të administratës shtetërore, organit tjetër shtetëror ose njësisë së vetëqeverisjes lokale, në pajtim me nenin 16-a paragrafi (3) të këtij ligji.

(3) Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet anëtarit të Këshillit Inspektues, nëse:

- nuk e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë se kryetari i Këshillit Inspektues nuk ka dhënë urdhëresë për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në pajtim me nenin 16-a paragrafi (4) të këtij ligji.

#### Neni 63 -b

Gjobë në shumë prej 7 500 deri në 15 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet drejtorit të Inspektoratit, përkatësisht funksionarit të organit të administratës shtetërore, nëse:

- nuk e miraton programin për punë të shërbimit inspektues, te Këshilli Inspektues në shqyrtim dhe marrje të mendimit në pajtim me nenin 15 paragrafi (1) të këtij ligji,

- nuk e miraton programin vjetor për punën e shërbimit inspektues, në afatin në pajtim me nenin 15 paragrafi (3) të këtij ligji,

- nuk dorëzon te Këshilli Inspektues plane tremujore në afatet nga neni 15 paragrafi (4) të këtij ligji dhe raporte tremujore për punën e inspektorëve nga neni 15 paragrafi (7) të këtij ligji ose raport vjetor për punën e Inspektoratit në pajtim me nenin 15 paragrafi (8) të këtij ligji,

- nuk vepron sipas urdhëresës për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese mbi punën e subjektit të caktuar të mbikëqyrjes, të lëshuar nga kryetari i Këshillit Inspektues në pajtim me nenin 16-a paragrafi (2) të këtij ligji,

- nuk e njofton Këshillin Inspektues për krijimin e rasteve nga neni 19-a paragrafi (1) të këtij ligji, në pajtim me nenin 19-a paragrafi (3) të këtij ligji dhe

- nuk kërkon para Këshillit Inspektues ngritje të procedurës disiplinore në pajtim me nenin 19-a paragrafi (4) të këtij ligji."

#### Neni 18

Inspektorët që kanë themeluar marrëdhënie të rregullt të punës para ditës së fillimit të zbatimit të këtij ligji, marrin licencë të përkohshme për inspektor pa dhënien e provimit për inspektor, e në afat prej dy vitesh nga fillimi i zbatimit të këtij ligji, duhet të marrin licencë në pajtim me nenin 5 të këtij ligji.

Nëse inspektori që e realizon të drejtën e pensionit në afat prej pesë vitesh nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi, nuk e merr licencën për inspektor në afatin paragrafi 1 të këtij neni, do ta humbë statusin e inspektorit dhe do të sistemohet në vend më të ulët të punës.

#### Neni 19

Këshilli Inspektues do të konstituohet në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 20

Këshilli Inspektues do ta organizojë dhënien e parë të provimit për inspektor në afat prej 12 muajsh nga fillimi i zbatimit të këtij ligji.

#### Neni 21

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.



Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", e do të fillojë të zbatohet në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi.